

Fragmente nga libri “Mikesha gjeniale”

Ç’ ishte plebeu e mësova vetëm atë çast, dhe shumë më qartë se atyre viteve kur më pyeti Olivieroja. Plebej ishim ne. Plebe qe ai garim i ushqimit me verën, ajo e grindur për ata që u shërbehej më parë e më mirë, ajo dysHEME e ndotur mbi të cilën kalonin e kalonin kamerierët, ato dolli gjithnjë e më vulgare. Plebe qe ime më, që kishte pirë e tani e lëshonte veten pas supit të tim eti serioz, dhe qeshte me gojën çapëlyer me aludimet seksuale të tregtarit të metaleve. Qeshnin të gjithë, edhe Lila, me pamjen e njeriu që ka një rol që e çon deri në fund.

S’kam mall për fëmijërinë tonë, se është plot dhunë. Çfarë s’na ndodhte, në shtëpi e jashtë saj, çdo ditë, por s’mbaj mend të kem menduar ndonjëherë se jeta që na kishte rënë për hise ishte veçanërisht e keqe. Jeta ishte e tillë dhe kaq, rriteshim me bindjen se duhet t’ua nxinim jetën të tjerëve, para se ata të na e nxinin neve. Sigurisht, mua do të më kishte pëlqyer mirësjellja për të cilën na bënë moral mësuesja dhe famullitari, por e ndieja që nuk ishte e përshtatshme për lagjen tonë, edhe sikur të ishte femër. Gratë kacafyteshin mes tyre më keq se burrat, kapeshin prej flokësh, lëndonin njëra-tjetrën. Lëndimi i tjetrit ishte sëmundje. Qysh fëmijë kam përfytyruar kafshë picërrake, thuajse të padukshme, që vinin natën në lagje, dilnin nga pellgjet, nga vagonët e trenave që s’përdoreshin më përtej argjinaturës, nga barishtet erëkeqe quajtur ndryshe “qelbëse”, nga bretkosat, salamandrat, mushkonjat, gurët e pluhuri, dhe futeshin në ujë, në ushqim e ajër, duke i shndërruar nënat dhe gjyshet tona, në buçe të tërbuara e të etura. Ishin të helmatisura më shumë se burrat, se meshkujt vërtet acaroheshin vazhdimisht, por në fund qetësoheshin, kurse femrat, që në dukje dukeshin të heshtura, të qeta, kur nxeheshin e shfrenin tërbimin deri në pikën e fundit, pa u ndalur më.

S’e kisha parë kurrë lakuriq, më erdhi turp. Sot mund të them që ishte turpi i të vështruarit me kënaqësi të trupit të saj, i të qenit dëshmitare e bukurisë së saj gjashtëmbëdhjetëvjeçare, para se Stefanoja ta prekte, ta penetronte, ta deformonte ndoshta duke e lënë shtatzënë. Asokohe qe veç ndjesia turbulluese e një trazimi të nevojshëm, një gjendje në të cilën s’i kthen dot sytë nga ana tjetër, nuk e largon dot dorën pa e pranuar turbullimin që ndien, pa e shpallur, pikërisht me atë largim, pra pa u ndeshur me pafajësinë e patrazuar të atij që po të turbullon, pa shprehur pikërisht me atë refuzim emocionin e dhunshëm që po të trondit, kështu që detyrohesh të qëndrosh, ta lëshosh vështrimin mbi shpatullat prej djaloshi, mbi gjoksin me thimthat e ngrirë, ijët e ngushta e vithet e tendosura, mbi seksin e zi, këmbët e gjata, gjunjët e buta, kaviļjet e valëzuara, këmbët elegante, duke u shtirë

sikur s'është asgjë, kur në fakt e gjitha po ndodh, është e pranishme aty, në dhomën e varfër e paksa të errët, rreth mobilieve të vjetruara, mbi një dysHEME të arnuar stërpikur me ujë, e të trondit zemrën, të ndez gjakun.

Tmerret që përjetonim ne çdo ditë... S'i besonim dritës mbi gurë, pallate, fshat, mbi njerëzit brenda dhe jashtë shtëpive. Nuhasnim qoshet e errëta, ndjenjat e ndrydhura, por gjithmonë gati për të shpërthyer. U vishnim atyre gojëve të errëta, shpellave që hapeshin edhe nën pallatet e lagjes, gjithçka që na trembte në dritën e diellit.

Ne fluturojmë mbi një top zjarri. Pjesa që është ftohur lundron mbi llavë. Mbi këtë pjesë ndërtojmë pallate, ura dhe rrugë. Hera-herës llava del nga Vezuvi ose bie ndonjë tërmet që na shkatërron gjithçka. Ngado ka mikrobe që të sëmurin e të vdesin. Ka luftëra. Ka një varfëri vërdallë që i bën të gjithë të ligj. Çdo sekondë mund të të ndodhë diçka që të bën të vuash sa mos të të shterojnë kurrë lotët. Dhe ti çfarë bën? Një kurs teologjik, ku rrekesh të kuptosh ç'është Shpirti i Shenjtë? Ç'merresh me të! Djalli e ka shpikur botën, jo Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë.

Kur s'ka dashuri, vyshket jo vetëm jeta e njerëzve, por edhe ajo e qyteteve. S'më kujtohet si e tha saktë, por koncepti që ky, dhe unë e lidha me rrugët tona të pista, kopshtet e pluhurosura, me fushën e përmytur prej pallateve të reja, me dhunën në çdo gjë, në çdo familje.